



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 512/16 Prot.

Tiranë, më 22/6/2017

REKOMANDIM

Nr. 23, datë 22/6/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", Tiranë:

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 127, datë 26.04.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

I. Kontrolluesi "Banka e Bashkuar e Shqipërisë" (UBA) ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "punëmarrës" (punonjës), manualisht dhe në format elektronik (përmes aplikimeve në faqen zyrtare online për vende vakante), për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe procesin e rekrutimit të punonjësve të rinj. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave cctv, adresa, të dhëna për shëndetin, etj.

Grupi hetimit konstatoi se, kontrolluesi "Banka e bashkuar e Shqipërisë" nuk i informon në mënyrë të plotë subjektet e të dhënave personale (kandidatë për punë), pasi në "Formatin e njoftimit për vendin e lirë të punës" dhe në "Formularin e aplikimit për vend të lirë pune" nuk reflektohen të gjithë elementet e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, sa i përket qëllimit dhe mënyrës së përpunimit të të dhënave, të drejtat që gëzojnë në cilësinë e subjektit të të dhënave dhe masat për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale (kandidatëve për pozicionin e lirë të punës) të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

2. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Grupi hetimit konstatoi se në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi nuk ka përditësuar njoftimin, në disa rubrika të formularit të njoftimit, konkretisht: 4.1 "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen" (nuk reflektohen të gjitha të dhënat që përpunohen referuar listës së dokumenteve që paraqiten nga punonjësi), 5.1 "Të dhëna sensitive që përpunohen" (nuk janë deklaruar të dhënat që mblidhen nëpërmjet raportit mjekësor për aftësi në punë), 6.1 "Qëllimi i përpunimit" (nuk parashikohet qëllimi i administrimit të marrëdhënieve të punës) 7.1 "Marrësit e të dhënave personale" (përhapje të dhënash personale në përmbushje të kontratës së sigurimit të punonjësve).

Detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 06.06.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar disa dokumente dhe prova në kuadër të masave të marra në zbatim të ligjit dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- ✓ Është përditësuar formati i "Njoftimit për vend të lirë pune" dhe "Formulari aplikimit për vend të lirë pune" në përputhje me kërkesat e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;
- ✓ Në zbatim të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është përditësuar Formulari i Njoftimit në përputhje me konstatimet e grupit të hetimit administrativ;

Sa më sipër.

Në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;

2. Kontrolluesi "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22/6 /2017

